



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 549/1 Prot.

Tiranë, më 29 /04/ 2020

V E N D I M

Nr.42 , Datë 29 /04/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.145 Regj, datë 12.11.2019, që i përket ankuesit M.T kundër Akademisë së Sigurisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon se, është banor i qytetit të Tiranës dhe pasi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe analizat e duhura për t’u bërë pjesë e Policisë së Shtetit ka aplikuar pranë Akademisë së Sigurisë, për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, për “Patrullë e Përgjithshme”. Ai shprehet se ka kaluar me sukses, madje me rezultate të konsiderueshme testimet me shkrim dhe ato fizike. Më pas, në akademi ka rezultuar se është me hepatit B. Pasi ka bërë të gjitha analizat, ka rezultuar se është thjesht bartës i hepatit B, jo aktiv dhe nuk është trasmetues.

Për këtë fakt ai ka paraqitur të gjitha analizat mjekësore specifike të shoqëruara me vërtetim nga institucionet shtetërore, sipas të cilave nuk përbën rrezik për shëndetin. Ankuesi shprehet se, në datën 03.10.2019 e kanë njoftuar nga Akademia për të bërë të gjitha analizat dhe aty i është thënë gojariht që nuk mund të ishte fitues sepse ishte me hepatit B. Ai ka kërkuar që vendimi i refuzimit t’i jepet me shkrim, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ankuesi ka bërë kërkesë me shkrim që t’i vihet në dispozicion dosja, por nuk ka marrë një përgjigje.

Në përfundim, ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit dhe të fillojë studimet.

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën nr.145 Regj, datë 12.11.2019, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”², që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjendjen shëndetësore (neni 1³). Ligji Për mbrojtjen nga diskriminimi, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjendjen shëndetësore, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në mënyrë të posaçme LMD parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit në Kreun III. LMD në nenin 17/1/ç⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që bazohet në gjendjen shëndetësore, që i bëhet një personi në gëzimin e të drejtës për arsim, duke përfshirë këtu pranimin në institucion arsimor. Bazuar në nenin 17/2 të LMD, ndalohet t’i refuzohet një personi ose grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik për shkak të gjendjes shëndetësore, si një nga shkaqet e mbrojtura nga neni 1, i LMD-së.

Bazuar në nenin 7, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, diskriminimi konsumohet si me veprim ashtu edhe me mosveprim nga ana e autoriteteve publike ashtu edhe subjekteve private, që e ekspozojnë personin apo grupin e personave ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona ose grupe personash të tjerë. Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr. 1726/1 prot., datë 14.11.2019, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Akademia e Sigurisë si subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa.
- Me shkresën nr.2623/1 prot, datë 18.11.2019, Akademia e Sigurisë ka njoftuar Komisionerin se çështja e pranimi në Akademinë e Sigurisë është kompetence e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën LMD..

³ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatëzinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 17/1/c/ç, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, **duke përfshirë pranimin**, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

- Me shkresën nr. 689/2-M prot., datë 04.12.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar parashtrimet në lidhje me çështjen dhe praktikën e aplikimit të ankuesit.
- Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁵ dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 22.01.2020, Komisioneri zhvilloi një senacë dëgjimore publike. Seanca u zhvillua me praninë e ankuesit i cili ishte personalisht prezent dhe në mungesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila edhe pse kishte rregullisht dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës nuk paraqiti asnjë shkak të ligjshëm për mosparaqitjen.
- Gjatë seancës dëgjimore ankuesi deklaroi se dëshiron të shtojë si subjekt kundër të cilit drejtohet ankesa Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Duke marrë shkas nga natyra specifike e ankesës, Komisioneri me shkresat nr. 64 prot., datë 14.01.2020 dhe nr.255 prot., datë 11.02.2020, ka kërkuar informacion nga Instituti i Shëndetit Publik, në lidhje me disa aspekte të Hepatitit B.
- Me shkresën nr.65/2 prot., datë 12.02.2020, Instituti i Shëndetit Publik ka dërguar informacionin e kërkuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Rezultoi e provuar gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës së ankuesi M.T, ka qenë aplikant në konkurimin për pranim në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPP), rezulton se pas verifikimit mbi plotësimin e kriterëve për pranimin në Akademinë e Sigurisë, të përcaktuara në nenin 38, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ankuesi është përzgjedhur për të vazhduar fazat e konkurimit, të parashikuara në pikën 1, të nenit 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015.

Ankuesi ka kaluar me sukses fazën e testimit me shkrim, testimit të aftësive fizike, intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit dhe testimit psikologjik, të parashikuara nga gërmat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 135, pika 1, të Rregullores së Policisë së Shtetit. Bazuar në gërmën “d”, të nenit 135, të Rregullores së Policisë së Shtetit faza e radhës e konkurimit është kontrolli shëndetësor.

Në bazë të nenit 137, të Rregullores së Policisë së Shtetit përcaktohet se :*“Aplikanti i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore pas përfundimit të procesit të testimit. Llojet e vizitave, ekzaminimeve, si dhe rregullat e kryerjes së tyre, përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.”* Në bazë të Procedurës Standarte për Pranimin në

⁵ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Akademine e Sigurisë, Kreu IV, “Kriteret Shëndetësore”, pika 8, “Kriteret për sëmundjet infektive”, përcaktohet se: “*Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe të mos jenë bartës të ndonjë sëmundje ngjitëse. Nuk do të pranohen ata aplikantë të cilët kanë antigen pozitiv (aktiv ose jo) Nëse kursanti gjatë periudhës së studimit del me Hbs pozitiv, largohet nga Akademia e Sigurisë. Nuk do të pranohen as ata aplikantë, të cilët janë bartës të hepatitit C apo virusit HIV dhe që mund të kenë vijueshmëri shenja përmirësimi*”. Gjatë fazës së kontrollit shëndetësor, nga ekzaminimet mjekësore të kryera nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor ankuesi ka rezultuar me Hepatit B (Hbs pozitiv). Meqënëse ankuesi nuk ka kaluar fazën e kontrollit shëndetësor, është s’kualifikuar nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor dhe ka humbur të drejtën për të kaluar në fazën tjetër të konkurimit. Sa më sipër, rezulton qartë se shkak i s’kualifikimit të ankuesit është pikërisht fakti që ai ka rezultuar me Hepatit B.

DPP gjatë shqyrtimit të ankesës ka mbajtur qëndrimin se, s’kualifikimi i ankuesit nuk ka ndodhur në kushte diskriminimi pasi ankuesi është s’kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin e Policisë së Shtetit dhe aktet e tjera normative që lidhen me kontrollin shëndetësor, si kusht për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë dhe t’u bërë efektiv i Policisë së Shtetit.

A.1 Në lidhje me statusin e Akademisë së Sigurisë

Krijimi i Akademisë së Policisë është parashikuar në nenin 37 të Ligjit “Për policinë e shtetit” në të cilin është përcaktuar se: “*1. Policia ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial.*” Akademia e Sigurisë është pjesë përbërëse e strukturës së Policisë së Shtetit dhe organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe për Policinë e Shtetit⁶.

Bazuar në nenin 17, pika 7, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se një nga llojet e institucioneve të arsimit të lartë është edhe Akademia. Referuar nenit 19, të këtij ligji, Akademia, është institucion i arsimit të lartë i profilizuar, që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. Referuar Statutit dhe Rregullores të Akademisë së Sigurisë, Akademia e Sigurisë është institucion publik i arsimit të lartë që synon arsimimin e punonjësve të policisë, që respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për arsimin e lartë dhe ligjin për Policinë e Shtetit.

Në këto kushte për të vlerësuar dhe gjykuar në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm që ankuesi pretendon se i ka ndodhur si rezultat i skualifikimit për të ndjekur Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë për shkak të gjendjes shëndetësore si person pozitiv me Hepatit B, Komisioneri do t’i referohet jo vetëm Ligjit “Për

⁶ VKM nr. 185 datë 25.02.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Policinë e Shtetit” dhe aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të tij, por edhe legjislacionit në fuqi që rregullon të drejtën për arsim dhe arsimin e lartë, meqenëse Akademia e Sigurisë është një institucion publik i arsimit të lartë.

Nga analiza e e neneve 143/5⁷ dhe 145⁸ të Rregullores së Policisë së Shtetit dhe nenit 6, pikat 1⁹ dhe 16¹⁰ të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, arrijmë në përfundimin se kursantët që ndjekin arsimin policor pranë Akademisë së Sigurisë gjatë kohës që ndjekin shkollën pranë këtij institucioni të arsimit të lartë, nuk konsiderohen punonjës policie. Marrëdhënia e punës për punonjësin e policisë fillon me aktin e emërimit në detyrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Kontrata që lidhet në momentin e pranimit të aplikantit të shpallur fitues nuk është një kontratë që rregullon marrëdhënien e punësimit, por të drejtat dhe detyrimet e shkollimit. Bazuar në sa më sipër Komisioneri vlerëson se, ankesa në fjalë ka të bëjë me të drejtën për arsim dhe jo me të drejtën për punësim. Megjithatë ndërlidhja që ka në këtë rast, për shkak të specifikës së arsimit të lartë policor, e drejta për arsim dhe e drejta për punësim, padyshim që janë mbajtur në konsideratë nga Komisioneri.

A.2 Ndërhyrja në të drejtën për arsim të ankuesit

Nëpërmjet skualifikimit të ankuesit për shkak se ka rezultuar me hepatit B, atij i është kufizuar e drejta për arsim. E drejta për arsim është një e drejtë e njeriut e mbrojtur nga Kushtetuta në nenin 57. E drejta për arsim përfshin të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit, duke filluar nga arsimi parauniversitar¹¹ (i cili përbëhet nga arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i lartë), arsimi i lartë (është arsim i cili ofrohet pas arsimit të mesëm nga institucionet e arsimit të lartë¹²), duke përfshirë dhe llojet e tjera të arsimit, si arsimi profesional dhe teknik. Referuar nenit 57, pika 4, e Kushtetutës përcaktohet se arsimi i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga **kritere aftësie**.

Protokolli Nr.1, Neni 2 i KEDNJ përmban një të drejtë të pavarur për arsimim, por jo absolute. Kufizimet në të drejtën për arsim ekzistojnë edhe pse nuk ka asnjë kufizim të shprehur në nenin 2, të Protokollit 1, të KEDNJ-së. Këto kufizime duhet të jenë të parashikueshme për të interesuarit dhe

⁷ Neni 143/5 i Rregullores së Policisë përcakton se: “Në momentin e pranimit aplikanti i shpallur fitues, nënshkruan kontratën me titullarin e Akademisë së Sigurisë. Në kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet gjatë shkollimit, si dhe qëndrimi në detyrë, jo më pak se 5 (pesë) vite, pas përfundimit të Akademisë së Sigurisë.”

⁸ Neni 145, i Rregullores së Policisë përcakton se : “Me përfundimin e shkollës bazë të policisë, kursanti pranohet punonjës policie, i jepet grada policore “Inspektor” dhe emërohet në detyrë me urdhër të Drejtorit të Policisë”

⁹ Neni 6, pika 1, e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar përcakton se: “Emërimi në detyrë është momenti i fillimit të marrëdhënies së punës për punonjësin e policisë

¹⁰ Neni 6, pika 16, e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar përcakton se: “Punonjës policie është personi i emëruar në strukturat e policisë pas përfundimit të arsimit policor që mban gradën policore.”

¹¹ Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

¹² Neni 6, pika 2, ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

të ndjekin një interes të ligjshëm, edhe pse nuk ka një listë shteruese të “interetit të ligjshëm” sipas nenit 2, të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së.¹³

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Sociale Ekonomike, Sociale dhe Kuturore, përcakton në nenin 13/2 se, arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë plotësisht të barabartë, në funksion të aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes falas. Përcaktimi se aksesimi në arsimin e lartë duhet të jetë i disponueshëm në bazë të aftësive merr në konsideratë që arsimi i lartë mund të mos jetë rruga që të gjithë dëshirojnë të ndjekin pas përfundimit të arsimit të mesëm.

Ligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton në nenin 2, se qëllimi i këtij ligji ndër të tjera është të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë. Në situatën konkrete ka qenë zgjedhje e ankuesit që të ndjekë arsimin e lartë pranë Akademisë së Sigurisë. Është gjithashtu e kuptueshme që ndjekja e arsimit të lartë pranë këtij institucioni publik të arsimit të lartë të kushtëzohet nga kriteret e meritës.

Referuar ligjit “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 38, të tij, përcaktohen kriteret e përgjithshme të pranimit të personave që dëshirojnë të ndjekin studimet e larta pranë institucionit arsimor policor. Në pikën 2, të këtij neni përcaktohet se: “2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të mos jetë i përjashtuar nga policia apo të jetë larguar nga shërbimi civil; c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën; d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm; dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur; e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B.”

Procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë, e cila është njëkohësisht pjesë e Policisë së Shtetit, rregullohen në Kreun II, nenet 126-144, të Rregullores së Policisë së Shtetit. Sipas nenit 126 të Rregullores së Policisë së Shtetit, përcaktohet se : “1. Pranimi në Akademinë e Sigurisë bazohet në parimin e shanseve të barabarta, meritës, mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës të drejtë, të paanshëm dhe transparent. 2. Proces i përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive të shkruarit, shprehurit, punës në grup, të aftësive komunikuese, psikologjike, fizike e shëndetësore, të garancive dhe sigurisë së kandidatit.”

Fazat e konkurimit, përcaktohen në nenin 135, të Rregullores së Policisë së Shtetit, ku parashikohet se : “1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurimit sipas rendit të mëposhtëm: a) testimit me shkrim; b) testimit të aftësive fizike; c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit; ç)

¹³ Udhëzues për Nenin 2 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut-E drejta për Arsim-Përditësuar më 31 Gusht 2019.

testimit psikologjik; d) kontrollit shëndetësor; dh) marrjes së shenjave të gishtave; e) verifikimi përfundimtar i aplikantit.

Rezulton se ankuesi ka kaluar katër fazat e para të konkurimit të përcaktuara si më sipër në nenin 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit. Ankuesi rezulton të jetë s'kualifikuar gjatë fazës së kontrollit shëndetësor. Kjo fazë e konkurimit, rregullohet nga neni 137 i Rregullores së Policisë së Shtetit, ku përcaktohet se: “1. Aplikanti i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore pas përfundimit të procesit të testimit. Llojet e vizitave, ekzaminimeve, si dhe rregullat e kryerjes së tyre, përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.”

Në bazë të nenit 136 të Rregullores së Policisë së Shtetit, përcaktohet se: “1. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë, është Drejtoria e Burimeve Njerëzore. 2. Struktura përgjegjëse për kryerjen e testimit me shkrim, testimit fizik, testimit psikologjik dhe intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit, është Akademia e Sigurisë, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e Akademisë së Sigurisë. 3. Struktura përgjegjëse për: a) kryerjen e kontrollit shëndetësor, është Komisioni i Kontrollit Shëndetësor; b) marrjen e shenjave të gishtave, është Drejtoria e Policisë Shkencore; c) verifikimin përfundimtar të aplikantit, janë strukturat vendore të burimeve njerëzore, sipas procedurave standarde të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.”

Në nenin 140, të Rregullores së Akademisë së Sigurisë¹⁴, përcaktohet se Akademia e Sigurisë është struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të konkurimit. Ky parashikim bie në kundërshtim me nenin 136 të Rregullores së Policisë së Shtetit dhe krijon përshtypjen se Akademia e Sigurisë është përgjegjëse për menaxhimin e gjithë procesit të konkurimit. Fillimisht edhe ankuesi e ka drejtuar ankesën e tij vetëm kundër Akademisë së Sigurisë dhe më pas ai shtoi si subjekt edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila në bazë të nenit 136 të Rregullores së Policisë së Shtetit është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë. Në mënyrë të posaçme faza e kontrollit shëndetësor sipas kësaj dispozite realizohet nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor, strukturë kjo e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

¹⁴ Neni 40, i Rregullores së AS: 1. Pranimi në një nga programet e studimit në Akademinë e Sigurisë, bëhet nëpërmjet procesit të konkurimit. Ky proces përmban një sërë testesh të cilët synojnë të verifikojnë aftësitë dhe cilësitë e konkurrenteve për të qenë pjesëtarë të Policisë së Shtetit, për të marrë përsipër dhe realizuar detyrat në mbrojtje të rendit, sigurisë publike dhe luftës ndaj krimit. 2. AS-ja është struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të konkurimit. Ajo organizon dhe realizon teste të ndryshme që verifikojnë e vlerësojnë dijet, njohuritë dhe zhvillimin intelektual, nëpërmjet testimit me shkrim; gjendjen, cilësitë dhe aftësitë fizike nëpërmjet provave dhe ushtrimeve vlerësuese, si dhe testimi psikologjik me anë të intervistës me gojë. 3. Konkurimi për pranimin në Kolegjin e Policisë, rjedhimisht në Policinë e Shtetit, i cili bazohet kryesisht në testimin me shkrim, provat e aftësive fizike dhe testimi psikologjik, ndërtohet në pershtatje me nivelet dhe ciklet e studimeve për të cilat aplikohet.....5. **Procesi i konkurimit për pranimin në Policinë e Shtetit, për ecurinë në karrierë, për fillimin e studimeve në nivele të ndryshme shkollimi e kualifikimi, etj., është i normuar me anë të procedurave standarde të konkurimit.**

Gjatë fazës së kontrollit mjekësor, bazuar në skedën mjekësore të hartuar për ankuesin dhe të vënë në dispozicion nga ana e DPP, ankuesi ka rezultuar me Hbs Ag Pozitiv, pra me Hepatit B. Bazuar në skedën mjekësore, Komisioni i Kontrollit Shëndetësor ka vendosur të s’kualifikojë ankuesin. Pra, kriteri i përcaktuar në Procedurën Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV “Kriteret shëndetësore”, pika 8 “Kriteret për sëmundjet infektive” ka sjellë s’kualifikimin e ankuesit e për rrjedhojë nëpërmjet përjashtimit, ka kufizuar të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë pranë Akademisë së Sigurisë.

Bazuar në nenin 140 të Rregullores së Policisë së Shtetit, aplikanti për Akademinë e Sigurisë, s’kualifikohet në rastet e mëposhtme: *a. Nuk kalon testimin me shkrim, b. Nuk kalon testimin e aftësive fizike, c. Nuk kalon testin psikologjik, nuk paraqitet në kohën e caktuar në një nga fazat e testimit, ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të fallsifikuara, pas procesit të verifikimit përfundimtar, rezulton se ai ose pjestarët e familjes së tij janë të dënuar për vepra të rënda penale, rezulton përdorues droge, rezulton të ketë varësi nga alkoli.* Sipas pikës 2, të këtij neni përcaktohet se, aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurimit, sipas rendit të përcaktuar në nenin 135 të kësaj rregulloreje, humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurimit dhe s’kualifikohet.

Sa më sipër rezulton se në asnjë prej rasteve të parashikuara nga pika 1 e nenit 140 të Rregullores së Policisë së Shtetit nuk parashikohet s’kualifikimi i aplikanti i cili mund të rezultojë me hepatit B. Pika 2, e nenit 140, të Rregullores përcakton vërtetë se aplikanti që nuk kalon një nga fazat e konkurimit humbet të drejtën për të kaluar në fazën tjetër dhe s’kualifikohet, por bazuar në nenin 140/1 të Rregullores s’kualifikim duhet të ndodh vetëm për një nga shkaqet e përcaktura në këtë pikë. Arsyeja e s’kualifikimit të ankuesit rezulton të jetë përcaktuar në Procedurat Standarte, të cilat kanë vendosur një kufizim përtej parashikimeve që bëhen në Ligjin Për Policinë e Shtetit dhe Rregulloren e Policisë së Shtetit që janë akte që qëndrojnë më lartë në hierarkinë e normave juridike se Procedurat Standarte të miratuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në një analizë të nenit 135 dhe 140 të Rregullores së Policë, rezulton se faza e kontrollit shëndetësor e përcaktuar nga neni 135 pritet që të japë informacion nëse personi është ose jo përdorues droge apo ka varësi nga alkoli, pasi këto dy raste të s’kualifikimit të përcaktuara nga neni 140/1, mund të rezultojnë nga një kontroll shëndetësor.

Kushtetuta ka përcaktuar se arsimi i lartë mund të kufizohet vetëm mbi bazën e kriterit të aftësisë. Në përputhje me Kushtetutën edhe ligji “Për arsimin e lartë” përcakton se barazia e shanseve dhe mundësive garantohet mbi bazën e meritës. Pakti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore shpjegon në Komentin e Përgjithshëm Nr. 13, së "*aftësia*" e individëve vlerësohet duke ju referuar të gjitha ekspertizave dhe eksperiencave përkatëse¹⁵. Statusi me hepatit B i aplikantit i cili është vendosur si kriter gjatë fazës së kontrollit shëndetësor në vlerësimin e Komisionerit nuk ka të bëjë

¹⁵ Komenti i Përgjithshëm nr. 13, paragrafi 19.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

me aspekte të eksperiencave dhe ekspertizes, që duhet të posedojë aplikanti, aspekte të cilat shërbejnë për të vlerësuar aftësinë e tij.

Nëse i referohemi legjislacionit të zbatueshëm për arsimin e lartë, i zbatueshëm në rastin konkret pasi Akademia e Sigurisë është një institucion i arsimit të lartë, nuk ka asnjë kriter përjashtues për personat me hepatit B që duan të ndjekin arsimin e lartë pranë institucioneve arsimore. Gjithashtu bazuar në nenin 18, pika 15, të ligjit nr. 15/2016 “*Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive*”, kushti që vendoset për pranimin e personave në çerdhe, kopsht, shkollë apo institucione të arsimit të lartë, është pajisja me një dokument që vërteton vaksinimin e kryer sipas kalendarit përkatës, por jo përjashtimi i tyre nga e drejta për të ndjekur arsimin.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar më datë 19.09.2001 Rekomandimin (2001)10 “*Mbi Kodin Evropian të Etikës së Policisë*”. Ndër të tjera në këtë dokument përcaktohen standarte në lidhje me kualifikimet dhe rekrutimin e personelit të policisë. Në paragrafët 22, 23, dhe 25 të këtij rekomandimi përcaktohet se: “*22. Personeli i policisë, në çdo nivel të hyrjes, do të rekrutohet në bazë të kualifikimeve dhe përvojës së tyre personale, e cila do të jetë e përshtatshme për objektivat e policisë. 23. Personeli i policisë duhet të jetë në gjendje të tregojë gjykim të shëndoshë, një qëndrim të hapur, pjekuri, drejtësi, aftësi komunikimi dhe, kur është e përshtatshme, aftësi drejtuese dhe menaxhuese. Për më tepër, ata duhet të kenë një kuptim të mirë të çështjeve sociale, kulturore dhe komunitare.25 Procedurat e rekrutimit bazohen në baza objektive dhe jodiskriminuese, pas shqyrtimit të nevojshëm të kandidatëve.....*”

Referuar ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku janë përcaktuar kriteret e përgjithshme të pranimit në Akademinë e Sigurisë, përcaktohet se personi që kërkon të pranohet në këtë institucion të arsimit të lartë duhet të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën. Rezulton se ankuesi pas verifikimit mbi plotësimin e kriterëve të përgjithshme të pranimit të parashikuara nga neni 38, i ligjit Për Policinë e Shtetit, është përzgjedhur për të vazhduar fazat e tjera. Kjo do të thotë se ankuesi është vlerësuar se ai është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën. Bazuar në raportin mjeko-ligjor me nr. 1326 regjistri datë 19.07.2019, lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor i Poliklinikës Nr.3, Tiranë, ankuesi ka rezultuar klinikisht i shëndoshë dhe i aftë për punë.

Faza e kontrollit shëndetësor është përcaktuar nga neni 135 e Rregullores së Policisë si një nga fazat që duhet të kalojë aplikanti për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Sipas nenit 137, të Rregullores së Policisë të gjitha llojet e vizitave dhe ekzaminimeve përcaktohen në Procedurat Standarte të miratuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Rregullorja nuk ka asnjë përcaktim në lidhje me faktin se cila gjendje shëndetësore mund të s’kualifikojnë aplikantin. Përcaktimi që bën Rregullorja në nenin 140/1 në lidhje me aspekte të cilat mund të lidhen me gjendjen shëndetësore është se aplikanti s’kualifikohet nëse rezulton përdorues droge dhe nëse ka varësi nga alkoli. Përcaktimet e tjera të kësaj pike të rregullores kanë të bëjnë me aspekte që nuk kanë lidhje me gjendjen shëndetësore të aplikantit. Pra, në asnjë prej parashikimeve që bëhen në

nenin 140/1 të Rregullores së Policisë së Shtetit nuk parashikohet se aplikanti s'kualifikohet në rast se rezulton me hepatit B.

Bazuar në Ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe Rregulloren e Policisë së Shtetit, të cilat rezultojnë lehtësisht të aksesueshme dhe të publikuara zyrtarisht (Fletore Zyrtare dhe faqen zyrtare në internet të Policisë së Shtetit) në mënyrë që të gjithë personat e interesuar mund të njihen me to, nuk rezulton që një person me hepatit B nuk përmbush kriteret për të qenë pjesë e Akademisë së Sigurisë. Përfundimi që u bëhet personave që janë pozitiv me hepatit B ashtu sikundër ankuesi është bërë me një urdhër të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për miratimin e Procedurave Standarte, ka dalë në bazë të Rregullores së Policisë së Shtetit, por ky akt nuk rezulton i aksesueshëm në mënyrë që personat e interesuar të njihen publikisht. Bazuar në legjislacionin e aksesueshëm siç është ligji Për Policinë e Shtetit dhe Rregullorja e Policisë së Shtetit, një aplikant i interesuar për të qenë pjesë i Akademisë së Sigurisë, nuk mund të arrijë të parashikojë në mënyrë të arsyeshme se të jesh me Hepatit B është një kriter që përjashtues.

Rregullorja e Policisë së Shtetit autorizon Drejtorin e Përgjithshëm që të përcaktojë vizitat mjekësore, ekzaminimet (dhe rregullat se si duhet te kryhen ato) që duhet t'i nënshtrohet aplikanti, por këto përcaktime duhet të jenë në përputhje me kriteret e vendosura në ligjin “Për Policinë e Shtetit dhe Rregulloren e Policisë së Shtetit. Në rastin konkret rezulton se rregullimi që Drejtori i Policisë ka bërë në Procedurat Standarte nuk është në përputhje me përputhje me këto akte.

Bazuar në nenin 141 të Rregullores së Policisë së Shtetit përcaktohet se aplikanti ka të drejtë të ankohet pas çdo faze të konkurimit. Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesës përcaktohen në Procedurat Standarte të miratuara me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit. Bazuar në Procedurat Standarte, Kreu VII, aplikanti ka të drejtë të ankohet pas çdo faze të konkurimit, brenda 2 ditëve pas përfundimit të saj dhe shqyrtimi i ankesës bëhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i cili ngrihet me urdhër të Drejtorit të Policisë.

Rezulton nga parashtrimet e ankuesit se në datën 03.10.2019 është njoftuar për të bërë analizat dhe në po të njëjtën ditë i është thënë gojarisht se nuk mund të ishte fitues pasi ishte me hepatit B. Gjithashtu ankuesi pretendoi se nuk i është vënë në dispozicion asnjë përgjigje zyrtare me shkrim. Me një kërkesë që mban datën 06.11.2019 ankuesi i është drejtuar Akademisë së Sigurisë me një kërkesë për t'i vënë në dispozicion vendimin dhe dokumentacion e dosjes së tij. Gjatë shqyrtimit nuk rezultoi që ankuesit t'i jetë vënë në dispozicion kopje e vendimit apo një dokument me shkrim për s'kualifikimin e tij. Nuk rezulton që ankuesi të ketë paraqitur ankesë në lidhje me skualifikimin. Por në kushtet kur ankuesit nuk rezulton t'i jetë vendosur në dispozicion asnjë dokument zyrtar në lidhje me arsyet e skualifikimit, Komisioneri vlerëson se e drejta e tij për t'u ankuar është cënuar.

Sa më sipër rezulton se, kufizimi i të drejtës për arsim të ankuesit parashikohet në një akt nënligjor siç është urdhri nr. 984 datë 17.12.2015, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

“Procedurat standarte për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve”. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është autorizuar për nxjerrjen e këtij urdhri nga neni 137 i Rregullores së Policisë. Ligji për Policinë e Shtetit dhe Rregullorja e Policisë së Shtetit në bazë të të cilave janë miratuar Procedurat Standarte janë akte lehtësisht të aksesueshme për individët e interesuar për t’u bërë pjesë e Akademisë së Sigurisë, por në fakt nuk përmbajnë asnjë parashikim nga i cili individët e interesuar të arrijnë të parashikojë në mënyrë të arsyeshme se të jesh me Hepatit B është një kriter që i përjashton. Nga ana tjetër Procedurat Standarte që parashikojnë ndërhyrjen në të drejtën për arsim të individëve me hepatit B, nëpërmjet parashikimit të kriterit përjashtues të përcaktuar në Kreun IV pika 8, nuk kanë qenë të aksesueshme nga ankuesi. Procedurat Standarte nuk rezultojnë të botuara në Fletore Zyrtare ose të jenë publikuar në mënyra të tjera nga Policia e Shtetit, si psh faqen zyrtare të institucionit të Policisë së Shtetit apo të Akademisë së Sigurisë.

Përveç mungesës së aksesueshmërisë Procedurat Standarte, vendosin një kufizim përtej përcaktimeve të Rregullores së Policisë, e cila në rastet e s’kualifikimit të përcaktuara nga neni 140/1, nuk parashikon s’kualifikimin e aplikantit nëse ai është me Hepatit B. Në Kreun IV pika 8, të Procedurave Standarte përcaktohet se aplikanti s’kualifikohet nëse rezulton me Hepatit B, ndërkohë që në Kreun VI të Procedurave Standarte thuhet se aplikanti s’kualifikohet në rastet e parashikuara në nenin 140 të VKM nr.750, datë 16.09.2015 *“Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”*, e cila nga ana e saj nuk rezulton të përmbajë asnjë kriter s’kualifikues që ka lidhje me statusin pozitiv me hepatit B. Ky fakt çënon jo vetëm ligjshmërinë e Procedurave Standarte, pasi ato vendosin një kufizim në kapërcim të kriterëve të parashikuara nga Rregullorja e Policisë, por njëkohësisht çënon qartësinë e aktit pasi ankuesi nuk mund të parashikojë në mënyrë të arsyeshme pasojat e parashikimeve që bëhen në këto dy akte.

Rregullorja e Policisë së Shtetit dhe Procedurat Standarte parashikojnë të drejtën e ankimit pas çdo faze konkurimi. Por në realitet ankuesi nuk ka patur mundësi ta ushtrojë të drejtën e ankimit në mënyrë efektive pasi, *së pari*, ankuesi nuk ka patur dijeni për mënyrën dhe afatet e ushtrimit të ankimit pasi Procedurat Standarte nuk kanë qenë të aksesueshme, *së dyti*, rezulton se ankuesit nuk i është vendosur në dispozicion një dokument i shkruar apo vendim në lidhje me arsyet e s’kualifikimit që ai të ushtronte të drejtën e ankimit edhe pasi ka bërë kërkesë me shkrim për t’i vënë në dispozicion kopje të vendimit dhe dosjes së tij.

Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se, kriteri përjashtues i përcaktuar në Procedurat Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV “Kriteret shëndetësore”, pika 8 “Kriteret për sëmundjet infektive”¹⁶ i cili përjashton personat që rezultojnë me Hepatit B, kufizon të drejtën për arsim të ankuesit. Komisioneri vlerëson se ky kufizim nuk është një kufizim që ka të bëjë me kritere të meritës apo aftësisë dhe se parashikimi në Procedurat Standarte ka çënuar aspekte të tilla të rëndësishme si

¹⁶ Miratuar me Urdhrin nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

aksesueshmëria dhe parashikueshmëria që duhet të përmbushë akti ligjor që ndërhyt në të drejtat dhe liritë e individit. Gjithashtu nga faktet dhe rrethanat e ankesës në shqyrtim rezulton se ankuesit i është cënuar e drejta për ankim. Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm.

B. Shkakut i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁷, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë edhe shkakun e gjendjes shëndetësore. Megjithatë jo shprehimisht e përfshirë në listën e shkaqeve të mbrojtura të KEDNJ-së, gjendja shëndetësore është përfshirë nga KEDNJ-ja në interpretimin e shkaqeve “të tjera” sipas nenit 14. Nëpërmjet praktikës së saj GJEDNJ-ja është shprehur se një diferencë bazuar në gjendjen shëndetësore të individit, përfshirë këtu jetesën me HIV, duhet të përfshihet nga termi i shkaqeve “të tjera” sipas nenit 14. (*Kiyutin kundër Rusisë*)

Neni 2/2 i Paktit Ndërkombëtar Për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, garanton mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Qëndrimi i shprehur në Komentin e Përgjithshëm nr. 20 datë 02.07.2009 për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore (KDESK), është se termi shkaqe “të tjera” mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të përfshijë “gjendjen shëndetësore”, përfshirë këtu jetesën apo statusin me HIV. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 20, datë 02.07.2009, KDESK shprehet se, gjendja shëndetësore i referohet shëndetit fizik ose mendor të personit.

Hepatiti viral është një grup i sëmundjeve infektive të mëlçisë. Ka disa lloje hepatitesh virale si hepatiti A, B, C, D dhe E, në varësi të llojit të virusit që e shkakton. Hepatiti B është një infeksion i mëlçisë i shkaktuar nga virusi i hepatitit B.

Në vitin 2010 Asambleja Botërore e Shëndetit ka miratuar rezolutën WHA63.18, e cila njeh hepatitin viral si një problem global të shëndetit publik dhe nevojën për të ndërmarrë veprime për të parandaluar, diagnostifikuar dhe trajtuar hepatitin viral. Në 24 maj 2014 Asambleja Botërore e Shëndetit ka miratuar rezolutën WHA67.6 për të promovuar veprime ndërkombëtare për të parandaluar, diagnostifikuar dhe trajtuar hepatitin viral. Njëkohësisht kjo rezolutë thekson nevojën për të luftuar dhe eliminuar stigmatizimin dhe diskriminimin e personave që jetojnë ose janë të prekur nga hepatiti viral dhe vendosmërinë për të mbrojtur dhe siguruar të drejtat e njeriut për këta persona.

¹⁷ Shih më lart *footnote* nr. 3.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Pasi ankuesi rezultoi me hepatit B gjatë fazës së kontrollit shëndetësor, ai u s’kualifikua dhe humbi të drejtën për të kaluar në fazën tjetër të konkurimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë për shkak të kriterit të përcaktuar në Procedurat Standarte, i cili përjashton aplikantët të cilët kanë antigen pozitiv (aktiv ose jo aktiv).

Për këto arsye, Komisioneri vlerëson se diferencat në trajtim që bazohen në faktin që një person jeton apo është prekur nga hepatiti B, do të konsiderohet si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen shëndetësore dhe sa më sipër rezulton se ankuesi ka të vërtetuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes shëndetësore.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo ka të drejtën për arsimim*”. Protokollin Nr.1, Neni 2 i KEDNJ përmban një të drejtë të pavarur për arsimim. Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të dhe për këtë arsye GJEDNJ-në i trajton ankimimet për diskriminim në fushën e arsimit të përfshira brenda sferës së Nenit 14.

Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹⁸

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

¹⁸ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Në mënyrë të posaçme LMD parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit në Kreun III. LMD në nenin 17/1/ç¹⁹, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që bazohet në gjendjen shëndetësore, që i bëhet një personi në gëzimin e të drejtës për arsim, duke përfshirë këtu pranimin në institucion arsimor. Bazuar në nenin 17/2 të LMD, ndalohej t'i refuzohet një personi ose grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik për shkak të gjendjes shëndetësore, si një nga shkaqet e mbrojtura nga neni 1, i LMD-së.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Duke mbajtur parasysh faktet dhe rrethanat e ankesës në shqyrtim si dhe bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljeve diskriminuese, rezulton se për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për arsim.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të njëjtë ose të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Rezultoi e provuar se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm. Kriteri i përcaktuar Procedurat Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV “Kriteret shëndetësore”, pika 8 “Kriteret për sëmundjet infektive”²⁰ i cili përjashton personat që rezultojnë me Hepatit B, kufizon të drejtën për arsim të ankuesit, i cili rezulton me Hepatit B.

C.1 Nëse ankuesi ishte në një situatë të njëjtë ose të ngjashme me atë të aplikantëve të tjerë që konkuronin për Akademinë e Sigurisë

Pasi është provuar trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm, elementi i dytë për ekzistencën e diskriminimit është fakti nëse ankuesi ndodhej në kushte të ngjashme me aplikantët e tjerë që konkuronin në të njëjtën kohë. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, diskriminimi do të thotë të

¹⁹ Neni 17/1/c/ç, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohej çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

²⁰ Miratuar me Urdhrin nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

trajtosht ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, personat në situata të njëjta, ose të ngjashme²¹.

Ankuesi ka kaluar me sukses fazat e konkurrimit sipas rendit të përcaktuar nga aktet përkatëse, pra testimin me shkrim, testimin e aftësive fizike, intervistën me gojë, ushtrimet vlerësuese dhe testimin e aftësive të shkruarit dhe në fund testimin psikologjik. Ankuesi u skualifikua për të kaluar në fazën tjetër të konkurrimit pasi ai rezultoi pozitiv me hepatit B. Ky shkak u konfirmua nga Drejtoria e Policisë së Shtetit si shkak i vetëm i skualifikimit të ankuesit për të vazhduar në fazat e tjera të mbetura të konkurrimit. Për këtë arsye Komisioneri vlerëson se ankuesi ndodhej në situatë të njëjtë me atë të aplikantëve të tjerë të cilët kishin kaluar me sukses sikundër edhe ankuesi deri në fazën e kontrollit shëndetësor, fazë të cilën ankuesi nuk e kaloi pikërisht për shkak të statusit të tij me hepatit B.

C.2 Nëse diferenca në trajtim bazohej në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo diferencë në trajtim konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe Kodi i Procedurave Administrative i kanë transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se nuk ka trajtim të diferencuar, ose që ky trajtim nuk është diskriminues.

²¹ Shiko: *D.H. kundër Republikës Çeke*, nr.57325/00, § 175, GJEDNJ 2007-IV, dhe *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, nr. 13378/05, § 60, GJEDNJ 2008

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Bazuar në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Duke ju rikthyer fakteve dhe rrethanave të ankesës në shqyrtim, rezulton se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm dhe se ky trajtim ka ardhur si rezultat i statusit pozitiv me hepatit B të ankuesit. Në këto kushte dhe bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të tregojë që kjo diferencë në trajtim mund të justifikohet. Siç është theksuar edhe më sipër, një justifikim i tillë duhet të jetë objektiv dhe i arsyeshëm ose, me fjalë të tjera, ai duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

C.3 Në lidhje me qëllimin e ligjshëm

Gjatë shqyrtimit të ankesës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk mbajti asnjë qëndrim në lidhje me faktin se cili ishte qëllimi për vendosjen e një kriteri për s’kualifikimin e aplikantëve të cilët kanë antigen pozitiv. Në mungesë të një qëndrimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Komisioneri nuk mund të mos analizojë kryesisht se cili mund të jetë në përputhje me rrethanat e ankesës në fjalë një qëllim i ligjshëm për s’kualifikimin e aplikantëve pozitiv me hepatit B.

Hepatiti B është një infeksion i mëlçisë i shkaktuar nga virusi i hepatitit B, që mund të shkaktojë infeksion akut dhe kronik të saj. Hepatiti B ashtu sikundër llojet e tjera të hepatiteve virale (A,C,D,E) hyn në kategorinë e sëmundjeve infektive. Për rrjedhojë parandalimi i rrezikut të infektimit të personave të tjerë padyshim që përbën një qëllim të ligjshëm për vendosjen e një mase të tillë kufizuese.

Një arsye tjetër për vendosjen e një kriteri të tillë nuk mund të mos ketë lidhje me faktin që në përfundim të shkollimit studentët e Akademisë së Sigurisë do të marrin gradën “Inspektor” dhe emërohen në detyrë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Policisë. Në këtë moment fillojnë marrëdhëniet e punës në policinë e shtetit dhe studentët fitojnë statusin e punonjësit të policisë. Për kryerjen e detyrave punonjësit e policisë duhet të jenë në gjendje për kryerjen e detyrave dhe padyshim që gjendja shëndetësore mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të kryer detyrat. Kështu që është e qartë se shqetësimi për të siguruar kapacitetin operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor përbën një objektiv të ligjshëm. Komisioneri do ta marrë në analizë edhe këtë

aspekt që ka të bëjë me fushën e punësimit për shkak të ndërlidhjes së ngushtë midis arsimit dhe punësimit që në rastin konkret ka arsimi i lartë policor. Megjithatë edhe në këto kushte interpretimi do të bëhet duke mbajtur më tepër në konsideratë mënyrën e rregullimit dhe funksionimit në fushën e arsimit dhe jo atë të punësimit.

C.4 Në lidhje me marrëdhënien e arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Sipas nenit 12/2 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur ky veprim është:

- *I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çënojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të palës.*
- *I përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe*
- *Në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.*

Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “.....nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementëve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.”

Bazuar në informacionin e siguruar nga Instituti i Shëndetit Publik, përfshirë këtu edhe informacionet e bëra publike prej tij në faqen zyrtare të institucionit²² dhe informacionin e siguruar nga faqja zyrtare në internet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë²³, virusi i hepatitit B mund të transmetohet nëpërmjet kontaktit me gjakun ose lëngjet e tjera trupore, si psh. sperma apo sekrecionet vaginale të një personi të infektuar. Rrugët kryesore të transmetimit të infeksionit të hepatitit B janë:

- *Transmetimi nga nëna tek fëmija, zakonisht ai përhapet nga nëna tek fëmija gjatë lindjes, ose gjatë ekspozimit ndaj gjakut të infektuar, kryesisht deri në 5 vitet e para të jetës*
- *Transmetimi nëpërmjet kontaktit seksual të pa mbrojtur ndodh kur bën seks me një person të infektuar pa përdorur prezervativ dhe rreziku shtohet më shumë kur personi ka më shumë se një partner seksual apo i ndërron shpesh ata.*

²² Shiko: www.ishp.gov.al

²³ Shiko: <https://www.who.int/hepatitis/en/>

- *Transmetimi nëpërmjet injeksioneve dhe transfuzioneve të pasigurta* mund të ndodhë nga ripërdorimi i ageve e shiringave që ka përdorur një person i infektuar me hepatit B, ose në persona që injektojnë drogë me të njëjtën shiringë që ka përdorur një person i infektuar me hepatit B, nëpërmjet kontaktit me gjakun e infektuar gjatë transfuzioneve të pasigurta. Infeksioni mund të ndodhë gjatë procedurave mjekësore, kirurgjike dhe dentare, bërjes së tatuazheve, ose nëpërmjet përdorimit të makinave të rrojes dhe objekteve të ngjashme që janë të ndotura me gjak të infektuar.

Hepatiti B nuk përhapet nëpërmjet kontaktit të përditshëm si: puthja, përqafimi, kollitja, tështitja, kapja apo shtrëngimi i duarve, ose përdorimi i përbashkët i enëve të guzhinës. Virusi i hepatit B nuk përhapet nga ushqimi apo uji i kontaminuar dhe nuk mund të përhapet rastësisht në vendin e punës.

Sipas *Udhërrëfyesit në lidhje me Epidemiologjinë, Elementët klinikë, Diagnostifikimin dhe Mjekimin e Hepatiteve Virale Akute, publikuar në dhjetor 2010*²⁴ masat parandaluese ndaj hepatiteve viral akute përfshijnë: hemotransfuzionin e sigurt, përdorimin e sigurt të injeksioneve, promovimin e praktikave të seksit të sigurt dhe imunizimin.

Gjasat që një infeksion me virusin e hepatit B të bëhet kronik, varet nga mosha në të cilën një person infektohet. Fëmijët më të vegjël se 6 vjeç të cilët infektohen me virusin e hepatit B kanë më shumë gjasa për të zhvilluar infeksione kronike. Ndërsa më pak se 5 % e personave që janë infektuar si të rritur do të zhvillojnë infeksion kronik. Ankuesi në rastin konkret është një person i rritur i cili kërkon të ndjekë Akademinsë e Sigurisë një institucion i arsimit të lartë dhe për rrjedhojë kontakti që ai do të ketë është me persona të tjerë madhorë të cilët kanë shumë pak gjasa që të zhvillojnë hepatit kronik B nëse infektohen si të rritur.

Nga studimet e seroprevalencës, të ndërmarra në vite nga ISHP, llogaritet se në vendin tonë rreth 200.000 mijë individë të jenë infektuar, nga hepatiti viral B. Një vaksinë kundër hepatit B është në dispozicion që nga viti 1982 duke parandaluar infeksionin dhe pasojat kronike të tij. Vaksina është 95 % e efektshme në parandalimin e infeksionit dhe pasojave kronike të tij. Vaksina e hepatit B është shtylla e parandalimit të hepatit B. Në vendin tonë, fëmijët që kanë lindur në prill të vitit 1994 dhe në vazhdim janë të vaksinuar kundër hepatit B, si pjesë e kalendarit bazë të vaksinimit. Kompletimi i plotë i skemës së vaksinimit shkakton nivele mbrojtëse në më shumë se 95 % të foshnjave, fëmijëve dhe të rriturve. Për këtë arsye për grupet që konsiderohen me rrisht rekmandohet vaksinimi. Punonjësit e policisë nuk rezultojnë të jenë pjesë e grupeve me rrisht lartë sikundër konsiderohen punonjësit e kujdesit shëndetësor.

Në vitin 2016, Organizata Botërore e Shëndetit ka hartuar *Strategjinë globale të sektorit të shëndetit mbi Hepatitin Viral, 2016-2021*. Krahas faktit se në këtë dokument hepatiti viral konsiderohet si një sfidë ndërkombëtare e shëndetit publik, e krahasueshme me sëmundje të tjera madhore ngjitëse,

²⁴ Udhërrëfyesi është përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 203 datë 09.04.2010 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Udhëzuesve të praktikës mjekësore dhe protokolleve klinike për Shërbimin e Infektivit”, të Ministrisë të Shëndetësisë.

përfshirë HIV, tuberkulozin dhe malarjen, kjo strategji ka identifikuar 5 fusha kryesore ku duhen fokusuar ndërhyrjet me qëllim eliminimin e epidemisë së hepatiteve, të cilat janë: Vaksinimi, parandalimi i transmetimit të virusit nga nëna te fëmija, siguria e injeksioneve, gjakut dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, zvogëlimi i dëmit për personat që injektojnë drogë dhe trajtimi i sëmundjes. Në Shqipëri nuk ka një strategji kombëtare mbi hepatitin viral.

Mënyrat e transmetimit të hepatit B janë të njëjta si për virusin HIV. Për këtë arsye në disa aspekte për shkak se aktet dhe raportet ndërkombëtare por edhe në nivel kombëtar janë më të shumta, Komisioneri gjen me vend që t'i referohet akteve dhe praktikës në lidhje me personat me Hiv/Aids. Akte të Agjencive të Kombëve të Bashkuara²⁵ dhe akte në kuadër të Këshillit të Evropës²⁶ theksojnë nevojën për të rishikuar dhe adresuar problemin e Hiv/Aids në të gjitha aspektet mjekësor, social dhe ekonomik. Këto akte theksojnë faktin se personat që jetojnë me HIV/Aids janë shpesh të stigmatizuar dhe diskriminuar për shkak të statusit të tyre dhe se garantimi i të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë është thelbësore në përgjigjen globale ndaj Hiv/Aids. Këto akte kërkojnë që shtete të marrin masa për të siguruar që legjislacioni, politikat dhe praktikat të respektojnë të drejtat e njeriut në kuadër të Hiv/Aids, në mënyrë të veçantë të drejtën për arsim, punë, privatësi, mbrojtje dhe akses në parandalim, trajtim, kujdes dhe mbështetje. Mbrojtja nga të gjitha format e diskriminimi për personat që jetojnë me Hiv/Aids në sektorin publik dhe atë privat.

Në mënyrë të veçantë në Udhëzimet Ndërkombëtare për Hiv/Aids dhe të Drejtat e Njeriut (versioni i konsoliduar 2006) botuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe UNAIDS, në udhëzimin nr.5 shteteve iu kërkohet që të miratojnë legjislacion mbrojtës dhe kundër diskriminimit për personat që jetojnë me Hiv/Aids. Në kuadër të udhëzimit 5, shteteve u kërkohet që legjislacioni i shëndetit publik, penal dhe legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi të ndalojnë testimin e detyrues për HIV për grupe të targetuara duke përfshirë grupet vulnerabël. Grupe të veçanta të punësuarish duhet gjithashtu të mbrohen nga testet e targetuara duke përfshirë këtu drejtuesit e kamionëve, marinarët, ushtarakët, punonjësit e policisë, punonjësit, punonjësit e industrisë së mikpritjes/turizmit. Ndër të drejtat themelore të njeriut të lidhura me Hiv/Aids janë :.....*e drejta për mosdiskriminim, mbrojtje e barabartë dhe barazi përpara ligjit..... e drejta për të patur akses të barabartë në arsim.....*

Bazuar në legjislacionin Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut, shtetet mund të vendosin kufizime për disa të drejta, në rrethana ngushtësisht të përcaktuara, nëse këto kufizime janë të nevojshme për të arritur qëllime madhore, të tillë si, shëndeti publik, të drejtat e të tjerëve, morali, rendi publik, e mira e përgjishthshme në një shoqëri demokratike dhe siguria kombëtare. Në mënyrë që kufizimet

²⁵ Rezoluta S-26/2, miratuar më datë 27.06.2001 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara “Deklaratë Angazhimi për Hiv/Aids; Rezoluta nr. 1995/44, e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut Për diskriminimin dhe stigmën në lidhje me Hiv/Aids; Udhëzimet Ndërkombëtare për Hiv/Aids dhe të Drejtat e Njeriut (versioni i konsoliduar 2006) botuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe UNAIDS.

²⁶ Rekomandimi 1116 (1989) Mbi Aids dhe të Drejtat e Njeriut, i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës; Rezoluta 1536 (2007) Mbi Hiv/Aids në Evropë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

e të drejtave të njeriut të jenë të ligjshme, shtetet duhet të tregojnë se kufizimi është parashikuar nga ligji dhe zbatohet në përputhje me ligjin; pra në përputhje me ligjin i cili është i aksesueshëm, i qartë dhe i saktë, në mënyrë që të jetë në mënyrë të arsyeshëm i parashikueshëm nga qytetarët e interesuar dhe bazohet në një interes legjitim, proporcional me interesin që synon të arrijë dhe të shkaktojë ndërhyrjen më të vogël në dispozicion²⁷.

Shëndeti publik përmendet shpesh nga shtetet si bazë për kufizimin e të drejtave të njeriut për personat me Hiv. Shumë prej këtyre kufizimeve, megjithatë përdoren si bazë të trajtimit ndryshe në lidhje me të drejtën për akses në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, udhëzim, sigurime shoqërore, strehim, etj²⁸.

Shtetet duhet të garantojnë që fëmijët dhe të rriturit që jetojnë me Hiv nuk ju refuzohet në mënyrë diskriminuese akses në arsim, duke përfshirë aksesin në shkollë, universitet, bursa dhe arsimin ndërkombëtar ose të jenë subjekt i kufizimeve për shkak të statusit me Hiv. Nuk ka asnjë shpjegim të arsyeshëm që bazohet në shëndetin publik me masa të tilla pasi nuk ka rrezik për transmetimin rastësor të Hiv në ambientet mësimore.²⁹

E drejta për punë shkelet në rast se një aplikanti ose punonjësi i kërkohet të bëjë test të detyruar për Hiv dhe i refuzohet punësimi, pushohet nga puna ose i refuzohet akses në përfitimet që vijnë nga punësimi për shkak se ka rezultuar pozitiv.³⁰

Në shumicën dërmuese të cilësimeve të profesioneve, puna nuk përfshin rrezik për të përvetësuar ose transmetuar Hiv ndërmjet punonjësve, nga punonjësit tek klienti ose nga klienti te punonjësi. Megjithatë kur ekziston mundësia e transmetimit në vendin e punës, si në rastin e ambienteve shëndetësore, shtetet duhet të marrin masa për minimizimin e transmetimit. Në mënyrë të veçantë punonjësit e sektorit të shëndetësisë duhet të trajnohen në mënyrën e duhur dhe të pajisen me masat e duhura dhe të nevojshme mbrojtëse³¹.

Shqipëria ka miratuar legjislacion për parandalimin dhe kontrollin nga Hiv/Aids. Ligji nr.9952 datë 14.07.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e Hiv/Aids” në nenin 8/1/b sanksionon se personat që jetojnë me Hiv/Aids kanë të drejtën të arsimohen në të gjitha nivelet e arsimit publik dhe privat. Sipas pikës 8/1/c të këtij ligji, personat që jetojnë me Hiv/Aids kanë të drejtë të arsimohen. Në nenin 16 të Ligjit 9952/2008, përcaktohet se institucioneve publike dhe private nuk iu lejohej të kundërshtojnë pranimin e nxënësit apo studentit apo ta largojnë atë në rast se është me Hiv/Aids. Në bazë të nenit 28, testimi për Hiv/Aids është vullnetar dhe testimi i detyruar bëhet vetëm në rastet

²⁷ Udhëzimet Ndërkombëtare për Hiv/Aids dhe të Drejtat e Njeriut (versioni i konsoliduar 2006) botuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe UNAIDS

²⁸ Shiko në të njëjtin burim si më sipër.

²⁹ Shiko në të njëjtin burim si më sipër.

³⁰ Shiko në të njëjtin burim si më sipër

³¹ Shiko në të njëjtin burim si më sipër.

e parashikuara nga neni 29, sipas të cilit parashikohet se : “*Dhuruesit e gjakut, dhuruesit e indeve dhe të organeve për transplant, dhuruesit për inseminim artificial janë të detyruar ti nënshtrohen testimin për Hiv. Ky testim është i detyrueshëm edhe për personat, për të cilët kërkohet zyrtarisht me vendim gjyqësor ose me kërkesën e prokurorit*”. Kodi i punës, në nenin 9, parashikon në mënyrë specifike mbrojtjen nga diskriminimi në punësim për shkak të jetesës me Hiv/Aids.

Bazuar në nenin 5, të ligjit Për Policinë e Shtetit, përcaktohet se ligjshmëria, mosdiskriminimi, proporcionaliteti dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë disa nga parimet mbi bazën e të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj. Këto parime janë të zbatueshme jo vetëm në veprimtarinë e policisë me të tretët por edhe brenda organizatës së saj. Këto janë parime të zbatueshme edhe për punonjësit e policisë.

Punonjësit e policisë duhet të gëzojnë parimisht të njëjtat të drejta civile dhe politike si qytetarët e tjerë. Kufizimi i këtyre të drejtave mund të bëhet vetëm kur është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të policisë në një shoqëri demokratike, në përputhje me ligjin dhe në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut³².

Në 6 korrik 2012 Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC), në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka përditësuar Rekomandimin për Menaxhimin e Virusit të Hepatitit B- Punonjësit e infektuar të kujdesit shëndetësor dhe studentët. Midis të tjerave në këtë dokument rekomandohet që infeksioni kronik me hepatit B, në vetvete, nuk duhet të përjashtojë nga studimet apo praktika profesionistët e mjekësisë, kirurgjisë, stomatologjisë, apo profesione të përafërta.

Në çështjen *I.B kundër Greqisë*, GjEDNJ-ja konsideroi si diskriminuese largimin nga puna të punonjësit bazuar vetëm në faktin se ai ishte pozitiv me HIV, pa marrë në konsideratë faktin se sëmundja e punonjësit nuk kishte ndikim në punën që ai kryente apo në funksionimin normal të kompanisë. Në këtë vendim GjEDNJ-ja ka marrë në konsideratë edhe materiale juridike krahasuese, ku ndër të tjera përmenden në paragrafët 45 dhe 46 të vendimit dy praktika të lidhura pikërisht me punonjësit e policisë dhe statusin e tyre me Hiv. Konkretisht rezulton se, në Kroaci, në vijim të ndërhyrjes së Ombudsmanit Rregullat e Brendshme të Policisë, të cilat më parë parashikonin që një person hoqim me HIV nuk mund të bëhej pjesë apo të qëndronte si punonjës policie në shërbim, u ndryshuan, ndërsa në 23 nëntor 2009 Gjykata Kushtetuese e Polonisë deklaroi antikushtetues një parashikim në Rregulloren e Ministrisë së Brendshme sipas të cilës çdo oficer policie i cili ishte pozitiv me HIV duhet automatikisht të deklarohet i papërshtatshëm për shërbim.

Sipas vërtetimit të lëshuar nga mjeku infeksionis ankuesi rezulton se është në gjëndje të mirë shëndetësore. Sipas përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) vetëm personat që janë me

³² Rekomandimi (2001)10 “*Mbi Kodin Evropian të Etikës së Policisë*”, miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më datë 19.09.2001.

hepatit akut B duhet të ndërpresin arsimin deri në përfundimin e fazës akute, sipas ligjit të sëmundjeve infektive nr. 15/2016. Një person që ka hepatit kronik B pra është bartës i hepatit B, si në rastin e ankuesit, nuk mund të ndalohej të ndjekë arsimin për aq kohë sa arsimi i tij nuk lidhet me mundësinë e kontaktit të gjakut apo lëngjeve trupore të peronit të sëmurë apo bartës me persona të tjerë. Në përgjigjen e ISHP nuk cilësohet se cilët janë ato kategori apo lloje të arsimit që kanë më shumë mundësi të kontaktit me gjakun apo lëngjet trupore. Sipas informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të ISHP në lidhje me hepatitin B thuhet se hepatiti B është një rrezik i madh në punë për punonjësit e shëndetësisë.

Referuar akteve ndërkombëtare të cituara në këtë vendim kategoria që cilësohet si më tepër e ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit me hepatit B apo Hiv është kategoria e punonjësve të sektorit shëndetësor. Në mënyrë specifike këto dokumenta nuk vendosin ndonjë rrezik të shtuar për infektim me hepatit B për kategori të ndryshme arsimi. Për më tepër që edhe rekomandimi i CDC në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, thekson që studentët e mjekësisë nuk duhet të përjashtohen thjesht për faktin se janë pozitiv me hepatit kronik B.

Për shkak të rrugëve të njëjta të transmetimit midis virusit Hiv dhe virusit të hepatit B, në rast se do të pranojmë, se punonjësit e policisë janë një nga grupet me rrezik edhe pse në mungesë të evidencave në mbështetje të këtij pohimi, rekomandimet që bëhen nga OBSH dhe CDC për punonjësit e sistemit shëndetësor do të jenë të vlefshme edhe për punonjësit e policisë. Këto dy institucione nuk rekomandojnë përjashtimin nga e drejta për arsim thjesht mbi bazën e statusit pozitiv me Hiv ose hepatit B apo përjashtimin nga puna apo kufizimin e aksesit në arsim, por rekomandohet mbështetja me trajnimet e duhura, politika dhe masa të posaçme për të parandaluar transmetimin dhe pajisjen me mjetet e duhura mbrojtëse duke përfshirë edhe vaksinimin e tyre.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa në fjalë pra kriteri që skulifikon aplikantët që rezultojnë pozitiv me Hepatit B (aktiv ose jo aktiv), nuk është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të parandalimit të transmetimit të sëmundjes. Ndalimi për të ndjekur arsimin mund të jetë i nevojshëm dhe i përshtatshëm gjatë fazës akute të hepatitit B, pra për një periudhë provizore dhe jo duke mohur aksesin në arsim për personat pozitiv me hepatit B. Kriteri në Procedurat Standarte mban plotësisht të drejtën e ankuesit për të ndjekur arsimin e lartë të zgjedhur prej tij. Një kufizim i tillë nuk bazohet në asnjë të dhënë, raport apo studim se ndjekja e studimeve apo puna si punonjës policie mbart një rrezik më të shtuar për transmetimin e virusit ndërkohë që potencialisht të gjithë njerëzit janë të rrezikuar për të infektuar.

Për të përforcuar përfundimin se kufizimi nuk është i nevojshëm dhe i përshtatshëm, është edhe fakti se standartet ndërkombëtare në këtë fushë ndalojnë autoritetet që t'i mohojnë dhe kufizojnë të drejtën nxënësve për të patur akses në arsim. Kufizimi për të ndjekur studimet në këtë institucion të arsimit të lartë nuk gjen mbështetje në masat që propozohen për parandalimin e përhapjes së virusit që janë, transfuzion i sigurt i gjakut, përdorim i sigurt i injeksioneve, promovimin e praktikave të seksit të sigurt dhe imunizimin nëpërmjet vaksinimit. Përjashtimi i ankuesit për të ndjekur arsimin e

zgjedhur prej tij nuk qëndron në një përpjestim të arsyeshëm me qëllimin për parandalimin e transmetimit të virusit

Komisioneri arrin në përfundim se kufizimi nuk është i nevojshëm dhe i përshtatshëm edhe për të arritur qëllimin tjetër legjitim sigurimi i kapacitetit operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor, pas përfundimit të Akademisë së Policisë.

Së pari, edhe pse është marrë në analizë ky qëllim është më tepër i lidhur me fushën e marrëdhënieve të punës, të cilat ende nuk janë krijuar në kohën që aplikanti ndjek arsimin pranë Akademisë së Sigurisë. Në thelb sigurimi i kapacitetit operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor, mund të përbëjë një kërkesë profesionale të domosdoshme, që është e lidhur me ushtrimin e aktiviteteve profesionale apo kushteve të profesioneve të caktuara, në kuptim të nenit 6 të Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në kushte të tjera një kriter i tillë nuk merret në konsideratë jashtë fushës së punësimit. Në rastin konkret ai do të mbahet parasysh për shkak të ndërthurjes së ngushtë midis fushës së arsimit dhe punësimit për situatën e punonjësve të policisë.

Vërtetë që arsimi i lartë kushtëzohet nga kriteri i aftësisë, por në rastin në fjalë kriteri shëndetësor nuk ka të bëjë me aftësitë dhe meritën e ankuesit. Nga të gjitha provat e administruara nuk rezulton që ankuesi për shkak të gjendjes shëndetsore nuk është i aftë të ndjekë arsimin. Ankuesi ka kaluar me sukses fazën e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme që parashikojnë se aplikanti duhet të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për punë. Ankuesi ka kaluar me sukses testimin me shkrim të njohurive dhe testimin fizik që janë të lidhura me vlerësimin e aftësive të tij. Bazuar në përgjigjen e ISHP gjithashtu thuhet se një person bartës i hepatit B mund të ndjekë arsimin me përjashtim të personave gjatë fazës akute të hepatit B. Sipas vërtetimit të lëshuar nga mjekja infeksioniste pranë Poliklinikës së Specialiteteve Nr.3 në Tiranë, ankuesi nuk është i sëmurë me hepatit B por është thjesht bartës i saj dhe nuk përbën rrezik shëndetin.

Gjithashtu aftësitë e punonjësit të policisë për të kryer detyrat testohen në mënyrë periodike dhe është një masë objektive për të përjashtuar mundësinë e mbajtjes në punë të punonjësve që nuk janë të aftë për të kryer detyrat. Gjendja shëndetësore e punonjësit të policisë që mund të ndikojë në aftësinë e tij për të kryer detyrat është objekt i kontroleve periodike, jo më pak se një herë në vit, sipas përcaktimeve në nenin 51 të Rregullores së Policisë së Shtetit. Ky parashikim bën një vlerësim individual dhe rast pas rasti të punonjësve në lidhje me aftësitë e tyre për të kryer detyrën. Në këtë mënyrë kufizimi i vendosur në Procedurat Standarte nuk vendos një raport të drejtë midis qëllimit të synuar dhe mjeteve të përdorura, pasi qëllimi i synuar mund të arrihet me mjete që vënojnë më pak të drejtën e personit.

Personat me HIV pozitiv përballen me një mori problemesh, jo vetëm mjekësore, por edhe profesionale, sociale, personale dhe psikologjike, dhe mbi të gjitha ndonjëherë me paragjykime të rrënjësura thellë edhe në mesin e njerëzve më të arsimuar. Injoranca për mënyrën se si përhapet sëmundja ka sjellë paragjykime të cilat, nga ana tjetër, stigmatizojnë ose marginalizojnë ata që janë të infektuar me virusin. (*shiko Kiyutin kundër Rusisë dhe I.B kundër Greqisë*) Nuk ka shumë studimeve në dispozicion që të tregojnë se si mungesa e njohurive në lidhje me përhapjen e virusit

të hepatit B çon në stigmatizimin dhe veçimin e personave që jetojnë me këtë virus. Po për shkak të ngjashmërisë së mënyrës së përhapjes së tij me virusin HIV, padyshim që kjo mund të çojë në të njëjtin rezultat si në rastin e personave me status HIV pozitiv.

Rezoluta WHA67.6 e Asamblesë Botërore të Shëndetit për të promovuar veprime ndërkombëtare për të parandaluar, diagnostifikuar dhe trajtuar hepatitin viral, pranon ekzistencën e stigmatizimit dhe diskriminimit, kur thekson nevojën për të luftuar dhe eleminuar stigmatizimin dhe diskriminimin e personave që jetojnë ose janë të prekur nga hepatiti viral dhe vendosmërinë për të mbrojtur dhe siguruar të drejtat e njeriut për këta persona.

Në këto kushte Komisioneri vlerëson se është cënuar parimi i proporcionalitetit pasi nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme midis qëllimit të ligjshëm të synuar dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Kufizimi i vendosur vendos një barrë jo të arsyeshme mbi ankuesin.

Në këto kushte, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë nuk arriti të provojë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin ndryshe të ankuesit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore si person pozitiv me hepatit B.

Procedurat Standarte vendosin kufizime edhe për personat me status HIV pozitiv dhe hepatit C. Këto dy kategori nuk janë objekt i ankesës në shqyrtim, megjithatë për të gjitha arsyet e mësipërme Komisioneri ngre shqetësimin se: largimi i kursantëve që mund të rezultojnë pozitiv me hepatit B gjatë periudhës që ndjekin studimet, trajton ndryshe kursantët për shkak të statusit të tyre pozitiv me hepatit B në raport me kursantët e tjerë dhe se s'kualifikimi i aplikantëve që janë pozitiv me hepatit C dhe me HIV trajton ndryshe personat për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore në krahasim me aplikantët e tjerë që kanë kaluar me sukses të njëjtat faza të konkurimit dhe kanë vazhduar në fazat e tjera pasi nuk kanë rezultuar me hepatit C apo HIV.

Komisioneri vlerëson se, Akademia e Sigurisë kundër të cilës është bashkëdrejtuar ankesa nuk ka kryer veprime të cilat kanë cënuar të drejtën për akses të barabartë në arsim të ankuesit. Përgjegjësia i takon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit pasi kriteri s'kualifikues është përcaktuar në Procedurat Standarte të miratuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Komisioneri vlerëson se, edhe nëse kriteri që s'kualifikon personat me status pozitiv të hepatit B do të ishte parashikuar në Ligjin "Për Policinë e Shtetit", për të gjitha arsyet e mësipërme një kriter i tillë nuk do ishte i përligjur nga një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm i ankuesit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore si person pozitiv me hepatit B, nuk ka një justifik objektiv dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë Komisioneri konstaton se ankuesi është diskriminuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore për të gëzuar akses të barabartë në arsim dhe se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka shkelur dispozitat e Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, nenin 17, pika 1, gërma ç dhe nenin 17, pika 2.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në të drejtën për arsim të ankuesit M.T, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke i dhënë mundësinë ankuesit që të kalojë në fazën tjetër të konkurimit të parashikuar në nenin 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për heqjen e kriterit s’kualifikues për personat pozitiv me hepatit B (aktiv ose jo aktiv) të parashikuar në Kreun IV, “Kriteret Shëndetësore”, pika 8, “Kriteret për sëmundjet infektive”, të Procedurave Standarte “Për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve”, të cilat janë miratuar me urdhrin nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për rishikimin në tërësi të Procedurave Standarte me qëllim identifikimin dhe eliminimin e kriterëve kufizues për të cilët nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marri masa për hartimin e politikave për parandalimin dhe trajtimin e hepatiteve virale dhe HIV/Aids në Policinë e Shtetit.
6. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit nga ana e Akademisë së Sigurisë.
7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
8. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
9. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Punoi : K.Keta, Inspektore DHA
Miratoi: V. Bushati, Drejtore DHA
Data: 21.04.2020